



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, më datë 04.06.2020, shpallë :

K O N K U R S PËR MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

I. ZYRTAR PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE

Drejtoria: Drejtoria e emergjencave dhe shërbimeve publike

Paga mujore(bruto)- 430.00€

Numri i referencës së vendit të punës:07-103/02- 10921/20

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësishë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave; 10%
2. Harton dhe zhvillon, politikat, standardet dhe normat për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të infrastrukturës publike komunale 15%
3. Përgatit dokumentet për projektet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes, përfshirë planin, specifikimet teknike, dokumentacionin e tenderëve, instruksionet, shtrirjen e punimeve dhe koston financiare;15%
4. Mbikëqyre zbatimin e kontratave të financuar nga buxheti komunal për ndërtimin e infrastrukturës publike si dhe ndihmon sektorët tjerë në administrimin e kontratave; 15%
5. Monitoron kontratat mbi ndërtimet dhe mirëmbajtjen e objekteve të financuara nga komunat dhe donatorët lidhur me respektimin e standardeve dhe normave të ndërtimit;15%
6. Ofron këshilla profesionale në fushë e ekspertizës së kërkuar brenda institucionit; 15%
7. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët: 10%
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Përveç kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta,

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkojnë:

- Diplomë universitare – Fakulteti i ndërtimtarisë/drejtimi konstruktiv
- Minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me ndërtimtarinë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet, Access AutoCAD, ArchiCAD si dhe atyre edituese: Indesign, Illustrator, Rhino etj.)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”-MSHV

Kohëzgjatja e emërimit : Gjashtë (6) muaj

Data e mbylljes së konkursit: mbetet i hapur 7 ditë nga dita e publikimit, prej **05.06.2020** deri më **11.06.2020**.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhës dhe në web-faqen komunale. Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomen e fakultetit të kryer apo kopjen e vërtetuar të diplomës, vërtetimin e përvojës së punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë” .

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

